

BULETINI MUJOR KLIMATIK CLIMATE MONTHLY BULLETIN

Meteorology

VOLUMI / VOLUME NR.6
NUMRI / ISSUE 69
SHTATOR / SEPTEMBER 2022

**UPT – IGEO
DEPARTAMENTI I METEOROLOGJISË
PUT – IGEO
DEPARTMENT OF METEOROLOGY**



IGEO, Rr. Don Bosko, Nr.60
Tirana – ALBANIA

ISSN: 2521-831X
www.geo.edu.al

Scientific & Editorial Board

Prof.Dr. Petrit ZORBA – Chief Editor & Member of the Department of Meteorology, PUT – IGEO, Tirana, Albania.

Akad. Neki FRASHËRI – Chairman of the Section of Natural Technical Sciences, Academy of Sciences, Tirana, Albania.

Ph.D. Çezar KONGOLI – Earth System Science Interdisciplinary Center (ESSIC), University of Maryland College Park & Visiting Scientist, National Oceanic and Atmospheric Administration (NOAA), Maryland, USA.

Dr. Azem BARDHI – Head of the Department of Meteorology, PUT – IGEO, Tirana, Albania.

Dr. Parid ALIMHILLAJ – Air traffic management agency of Albania & associated lecture at Polytechnic University of Tirana (PUT), Albania.

External Reviewers:

Dr. Peter Romanov, Research Scientist, NOAA-CREST City University of New York at NOAA/NESDIS Office of Satellite Applications and Research (STAR), USA.

Ph.D. Sante Laviola, - National Research Council of Italy (CNR), Institute of Atmospheric Sciences and Climate (ISAC), Bologna, Italy.

English Supervisor: Ing. Elsuida HOXHA, PhD Student, Grove School of Engineering, CUNY, NY, USA

Editorial Board approved by the Director of IGEO – Prof.Dr. Ylber MUÇEKU

Ky buletin u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Meteorologjisë së IGJEO sipas rubrikave si vijon:
This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Meteorology of IGEO by rubrics as follow:

Data digitalization: M.Sc. G. Çela & st. J. Lalaj

Data control, verification & elaboration:

Prof. P. Zorba, Ing. E. Hoxha & M.Sc. G. Çela.

Evaluation of monthly meteorological characteristics:

Prof. P. Zorba, M.Sc. G. Çela.

Precipitation maps of Albania, composed by applying GIS models:

M.Sc. G. Çela.

Solar radiation: M.Sc. G. Çela & M.Sc. Ing. E. Hoxha.

Air temperatures: Prof. P. Zorba & Ing. E. Hoxha.

Agrometeorology: Prof. P. Zorba & Dr. C. Kongoli (NOAA).

Drought: Prof. P. Zorba & M.Sc. E. Hoxha.

Climate change: Prof. P. Zorba & Ing. E. Hoxha.

Renewable Energy: Prof. P. Zorba & Ing. E. Hoxha.

Scientific Information: Prof. P. Zorba.

Cover of this bulletin is composed and prepared by E. Hoxha.

Tirana, Albania © 2022 Institute of Geosciences, PUT.



PËRMBAJTJA / CONTENTS

0 X	HYRJA INTRODUCTION
05	RREZATIMI DIELLOR SOLAR RADIATION
06	TEMPERATURAT TEMPERATURES
18	RESHJET PRECIPITATION
23	AGROMETEOROLOGJI AGROMETEOROLOGY
26	THATËSIRA DROUGHT
27	ENERGJITË E RINOVUESHME RENEWABLE ENERGIES
29	NDRYSHIMET KLIMATIKE CLIMATE CHANGE
31	METEOROLOGJI & HISTORI METEOROLOGY & HISTORY
32	INFORMACION SHKENCOR SCIENTIFIC INFORMATION

Buletini Mujor Klimatik Nr. 69 - 2022 ndodhet i publikuar në faqen "on line" të OBM, UPT, IGEO dhe një sërë institucioneve të tjera. Për buletinet e tjera mund të klikoni në logot përkatëse, që ndodhen në vijim.

Monthly Climate Bulletin Nr. 69 - 2022 is published on the web site of WMO, PUT, IGEO and other institutions. For the other bulletins you can klik on the respective logo, that are listed below.



Hyrije

Gjatë muajit shtator 2022 më datë 23 u shënua dhe ekuinoksi i vjeshtës, moment kohor kur barazohet kohëzgjatja e ditës me atë të natës.

Ndërkohë duhet thënë se ecuria e elementeve kryesore meteorologjike për këtë muaj, temperaturat e ajrit dhe reshjet atmosferike përcollën në tërësinë e tyre një situatë mbizotëruese me mot relativisht të ngrohtë, por me vranësira në rritje dhe një tendencë rënie të temperaturave.

Introduction

During the month of September 2022, on the 23rd, the autumn equinox was also marked, a moment in time when the duration of the day equals that of the night.

Meanwhile, it must be said that the performance of the main meteorological elements for this month, air temperatures and atmospheric precipitation in their entirety conveys a dominant situation with relatively warm weather, but with increasing cloudiness and a tendency for temperatures to drop.



Sky view over Tirana on date 20.IX.2022. Photo credit: P. Zorba.

Kësisoj bashkë me praninë e reshjeve, të cilat shënuan vlera mbi normë, siç do të shihet më në detaje në vijim në këtë buletin, ofruan një muaj shtator më pranë vlerave të normës krahasuar me ato të viteve 1991-2020 dhe paksa më të ngrohtë krahasuar me atë të periudhës 1961-1990.

Kjo vjeshtë e parë për territorin e Shqipërisë nuk përcolli dukuri ekstreme të motit dhe me pasoja të dëmshme për jetën dhe veprimtarinë ekonomike të vendit.

Thus, together with the presence of precipitation, which marked values above the norm, as will be seen in more detail later in this bulletin, they offered a month of September close to the norm values of those of the years 1991-2020 and slightly warmer compared to that of the period 1961-1990.

This first autumn for the territory of Albania did not bring extreme weather events with harmful consequences for the life and economic activity of the country.

Rrezatimi Diellor

Paqëndrueshmëritë atmosferike që ishin më të shpeshta gjatë muajit shtator 2022 shoqëruar me vranësira e reshje krahas zvogëlimit të kohëzgjatjes së ditës dhe natyrisht dhe të rrezatimit diellor mundësuan një numër ditësh me diellëzim më të ulët në krahasim me muajin e mëparshëm.

Gjithësesi një informacion më të plotë mbi diellëzimin e muajit shtator 2022 e marrim në hartën e dhënë në figurën Nr.1.

Ndërkohë në grafikët e dhënë në figurën Nr.2 paraqiten të dhenat e diellëzimit për tre vendmatje meteorologjike të Shqipërisë, ato të Koplikut, Fierit dhe Pogradecit.

Gjatë muajit shtator 2022 u shënuan vlera rreth 25% më të ulta të treguesit të diellëzimit në krahasim me muajin e mëparshëm gusht.

Siç shihet pjesa më e favorizuar në ecurinë e vlerave të diellëzimit për këtë muaj ka qenë pjesa qendrore dhe jugore e Ultësirës Perëndimore.

Zonat malore kryesisht si dhe pjesa veriore, siç do shihet dhe në vijim në analizën e reshjeve, që u karakterizua me më shumë

Solar Radiation

Atmospheric instabilities that were more frequent during the month of September 2022 accompanied by cloudiness and rain in addition to the reduction of the length of the day and of course the solar radiation enabled a number of days with lower sunshine compared to the previous month.

However, we can get more complete information about the sunshine in September 2022 in the map given in figure No.1.

Meanwhile, in the graphs given in figure No.2, the sunshine data for three meteorological measuring sites in Albania, those of Koplik, Fierir and Pogradec, are presented.

During the month of September 2022, about 25% lower values of the sunshine indicator were recorded compared to the previous month of August.

As can be seen, the most favored part in the progress of sunshine values for this month was the central and southern parts of the Western Lowlands.

Mainly mountainous areas as well as the northern part, as will be seen below in the analysis of precipitation, which was character-




Figure Nr.1. - Kohëzgjatja e diellëzimit (në orë) për muajin Shtator 2022.
Sunshine duration (in hours) for September 2022 (EUMESAT).

vransira dhe reshje paraqiti vlera më të ulta të këtij treguesi.

-rized by more cloudiness and precipitation presented lower values of this indicator.






Figure Nr.2. - Vlerat e rrezatimit diellor (në orë) për vendmatje meteorologjike të Koplikut dhe Fierit për muajin shtator 2022. / Values of solar radiation (in hours) for the meteorological station of Koplik and Fier for September month 2022.

Temperaturat

Temperaturat e ajrit gjatë muajit shtator 2022 u kthyen pranë vlerave të normës për Shqipërinë.

Në shkallë globale ato shënuan vlerë:

- 0.35°C më ngrohtë se mesatarja 1991-2020 për shtatorin si dhe ju bashkëngjiten shtatorit të përbashkët të 4-të më të ngrohtë (brenda 0.01°C), atij të vitit 2016;
- si dhe më i freskët me rreth 0.08°C se shtatori 2020, si shtatori më i ngrohtë.

Anomali të e temperaturës mesatare europiane janë përgjithësisht më të mëdha dhe më të ndryshueshme se anomali të globale.

Temperatures

Air temperatures during the month of September 2022 returned close to the norm values for Albania.

Globally, September 2022 was:

- 0.35°C warmer than the 1991-2020 average for September and the joint 4th warmest September (within 0.01°C) with September 2016
- cooler by about 0.08°C than September 2020, the warmest September.

European-average temperature anomalies are generally larger and more variable than global anomalies.




Figure Nr.3. - Anomali të e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin Shtator 2022 kundrejt periudhës 1991 ÷2020 në shkallë globale dhe për kontinentin Europian. Surface air temperature anomaly in global scale and for the European continent for September 2022 compare to the period 1991 ÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).




Figure Nr.4. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin Europian për muajin Shtator 2022, sipas NOAA-s. / Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of September 2022, according to NOAA.

Në figurën Nr.3 dhe Nr.4 paraqiten në hartat përkatëse temperaturat mesatare të ajrit në shkallë globale dhe Europiane si dhe anomalitë për kontinentin European për muajin shtator 2022.

Temperatura mesatare europiane për shtatorin 2022 ishte 0.37°C nën mesataren 1991-2020, e cila është më e ftohta që nga viti 2013 kur anomalia ishte 0.40°C nën periudhën e referencës 1991-2020, ku dallon një brez temperaturash nën mesatare nga Europa Qëndrore deri në Rusi.

In figure No.3 and No.4, the average air temperatures on a global and European scale as well as anomalies for the European continent for the month of September 2022 are presented on the respective maps.

The European-average temperature for September 2022 was 0.37°C below the 1991-2020 average which is the coolest since 2013 when the anomaly was 0.40°C below the 1991-2020 reference period, with a band of below-average temperatures from central Europe to Russia.




Figure Nr.5. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin European për 4 javët e muajit Shtator 2022, sipas NOAA-s. / Average values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of September 2022, according to NOAA.

Si në të tre javët me anomali pozitive ashtu dhe në javën me anomali negative referuar hartave në figurën Nr.5 territori i Shqipërisë rezultoi si dhe në raste të mëparshme, të jetë në periferinë e ndikimit të këtyre situatave.

Both in the 3 weeks with positive anomalies and in the week with negative anomalies, referring to the maps in figure No.5, the Albanian area turns out, as in previous cases, to be in the periphery of the influence of these situations.

Greenland kishte temperatura të jashtëzakonshme, që arritën më shumë se +8°C mbi mesataren mujore në teritor, si dhe temperaturat më të ngrohta për shtatorin në serinë e vrojtimeve.

Këto temperatura mesatare europiane nën mesataren 1991-2020 ishin kryesisht për shkak të një rajoni me temperatura nën mesataren që shtrihet nga Europa Qendrore në Finlandë dhe Rusi. Në të kundërt, temperaturat ishin përgjithësisht mbi mesataren në Europën Perëndimore, me rajonin e Mesdheut që ende reflektonte valën e të nxehtit detar që ndodhi gjatë verës.

Shqipëria kundrejt periudhës 1961-1990 shënoi anomali relativisht të vogla mbi normë me +0.9°C, ndërsa kundrejt periudhës 1991-2020 siç shihet në hartën e dhënë në figurën Nr.5 pjesa më e madhe ishte pranë vlerave të normës, me përjashtim të pjesës JL që shënoi anomali të vogla pozitive.

Në paraqitjen grafike të dhënë në figurën Nr.6 pasqyrohen të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për muajin shtator 2022, që i përkasin zonave dhe nënzonave të ndryshme klimatike të vendit.

Greenland had exceptional temperatures that reached more than +8°C above the monthly average in places, the warmest temperatures for September in the record.

This European-average temperature below the 1991-2020 average was largely due to a region of below-average temperatures stretching from central Europe to Finland and Russia. Conversely, temperatures were generally above average in western Europe, with the Mediterranean region still reflecting the marine heatwave that occurred during the summer.

Albania, compared to the period 1961-1990, noted relatively small anomalies above the norm with +0.9°C, while compared to the period 1991-2020, as seen in the map given in figure No.5, most of it was close to the norm, with the exception of the part SE who noted small positive anomalies.

In the graphic representation given in figure No.6, the data of the average air temperature for several meteorological stations selected for the month of September 2022, which belong to different climatic zones and sub-zones of the country, are reflected.




Figure Nr.6. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / Values of mean air temperatures for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.

Anomali të më të theksuara i shënuan vlerat e temperaturave maksimale të ajrit. Për Shqipërinë siç paraqiten dhe grafikisht në figurën Nr.9 ato shënuan një shmangie ndaj normës në masën prej +1.5°C. Tendenda në rënie graduale e vlerave të temperaturave gjatë muajit shtator 2022 paraqitet për 12 vendmatje

The most pronounced anomalies marked the values of the maximum air temperatures. For Albania, as presented graphically in figure No.9 they noted a deviation from the norm in the amount of +1.5°C. The tendency in the gradual decrease of temperature values during the month of September 2022 is presented for

meteorologjike për Shqipërinë në figurën Nr.8/1/-8.12, ku pasqyrohen vlerat ditore jo vetëm të temperaturave minimale e maksimale, por dhe vlerat e reshjeve 24 orëshe.

12 meteorological stations for Albania in figure No.8/1-8/12, where daily values are reflected not only of minimum and maximum temperatures, but also the value of 24-h rainfall.




Figure Nr.7. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 4 javët e muajit Shtator 2022, sipas NOAA-s. / Extreme maximal values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of September 2022, according to


Nërkohë në ngjashmëri me muajin gusht pjesa e parë e muajit shtator vijoi të ruaj temperatura maksimale të larta, të cilat ishin mbi pragun 30°C në mjaft vendmatje meteorologjike të vendit. Në figurën Nr.10 paraqiten të dhënat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për muajin shtator 2022.

Një situatë e ngjashme sa i takon temperaturave makaimale te ajrit mbizotëroi në mbarë kontinentin European, siç kjo paraqitet

Meanwhile, similar to the month of August, the first part of the month of September continued to maintain high maximum temperatures, which were above the 30°C threshold in many meteorological stations of the country. In figure No.10, the data of the maximum absolute air temperatures for the month of September 2022 are presented.

A similar situation regarding extreme air temperatures prevailed throughout the European continent, as it appears

Figure Nr.8/1÷8/12 -Temperaturat ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin Shtator 2022 në Shqipëri.
The daily temperatures for some meteorological stations for September month 2022 in Albania.






Figure Nr.9. – Temperaturat maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / The maximal air temperature for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.




Figure Nr.10. – Temperaturat maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / The maximal absolute air temperature for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.

dhe në hartat e 4 javëve të muajit shtator 2022 dhënë në figurën Nr.7.

Vlerat maksimale absolute të temperaturave të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë paraqiten në grafikun e dhënë në figurën Nr.10, ku në mjaft raste vlerat shënohen në kufijtë 30-35°C.

Gjatë këtij muaji temperaturat e ajrit ndonë në një ulje graduale shënuan vlera minimale dhe u shoqëruan me anomali relativisht të vogla pozitive me vlerë +0.4°C, siç tregohet dhe në figurën Nr.11.

Gjithësesi nuk munguan temperaturat mbi pragun 20°C gjatë netëve të para të muajit, të ashtuquajtura dhe netë tropikale, sidomos në hapësirat që konsiderohen dhe si “ishuj urbane temperature” ilustruar me paraqitjen grafike dhënë në figurën Nr.12.

in the maps of the 4 weeks of September 2022 given in figure No.7.

The absolute maximum values of air temperatures for several meteorological stations in Albania are presented in the graph given in figure No.10, where in many cases the values are marked in the range of 30-35°C.

During this month, the air temperatures, although in a gradual decrease, marked minimum values and were accompanied by relatively small positive anomalies with a value of +0.4°C, as shown in figure No.11.

However, there were no shortage of temperatures above the 20°C threshold during the first nights of the month, so-called tropical nights, especially in the spaces that are considered "urban temperature islands" illustrated by the graphic presentation given in figure No.12.




Figure Nr.11. - Vlerat e temperaturave minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / Values of minimal air temperatures for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.




Figure Nr.12. – Treguesi i numrit të netëve me temperaturë minimale të ajrit mbi pragun 20°C për vendmatjen meteorologjike të Tiranës për muajin shtator gjatë periudhës 2002–2022. The value of the index of day number with minimal air temperatures over the threshold 20°C for the meteorological station of Tirana for September month referring to the period 2002 ÷ 2022.

Temperaturat minimale ekstreme në shkallë kontinentale si dhe për Shqipërinë paraqiten në hartat e dhëna në figurën Nr.14 dhe grafikun e figurës Nr.13.

Minimum extreme temperatures on a continental scale as well as for Albania are presented in the maps given in figure No.14 and the graph in figure No.13.




Figure Nr.13. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për Shqipërinë për muajin Shtator 2022. / Extreme minimal values of air temperatures for Albania for September 2022.




Figure Nr.14. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 4 javët e muajit Shtator 2022, sipas NOAA-s. / Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of September 2022, according to





Figure Nr.15. – Pamje e vranësirave në Tiranë, të pranishme në mjaft ditë gjatë muajit shtator 2022. View of cloudiness in Tirana, present during many days on September 2022.

Një karakteristikë e veçantë e këtij muaji ishte prania më e lartë e vranësirave. Mbulesa me re si ato të ulta dhe ato të mesme ilustrohet si në figurat Nr.15 ashtu dhe në pamjet satelitore të paraqitura në figurën në vijim Nr.16.

A particular characteristic of this month was the higher presence of clouds. The cloud cover, both low and medium, is illustrated in figures No.15 as well as in the satellite images presented in the following figure, No.16.

Prania e vranësirave ndikoi dhe në ecurinë e amplitudave të temperaturave të ajrit, të cilat shënuan një ulje kundrejt muajve të mëparshëm.

The presence of cloudiness also affected the progress of air temperature amplitudes, which marked a decrease compared to previous months.



*Figure Nr.16. - Situata e vranësirave mbi territorin e shqiperise gjate maujit shtator 2022.
The cloud cover over Albanian territory during September 2022. (EUMETSAT)*

Reshjet

Reshjet gjatë muajit shtator 2022 ishin të pranishme në mbarë kontinentin European. Ato me përjashtime të zonave të kufizuara ishin mbi nivelin e normës. Shqipëria siç shihet dhe në hartën e dhënë në figurën Nr.17/a me reshjet në shkallë kontinentale ashtu dhe anomalive përkatëse të tyre në figurën Nr.17/b pati reshje mbi normë në pjesën veriore, ndërsa në gjysmën jugore u karakterizua me anomali negative.

Precipitation

Rainfall during the month of September 2022 was present in all the European continent. With the exception of limited areas, was above the normal level. Albania, as can be seen in the map given in figure No.17/a, with rainfall on a continental scale, as well as the corresponding anomalies in figure No.17/b, had precipitation above the norm in the northern part, while in the southern half it was characterized by negative anomalies.




Figure Nr.17. - Reshjet për muajin Shtator 2022 në kontinentin European dhe anomali të kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s. / Rainfall for September 2022 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981÷2010 according to NOAA.

Të dhënat e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike për muajin shtator 2022 si dhe vlerat e normës për Shqipërinë paraqiten grafikisht sëbashku me të dhënat e normës në figurën Nr.18.

The precipitation data for some meteorological stations for the month of September 2022 and as well norm values for Albania are presented graphically together with the norm data in figure No.18.




Figure Nr.18. – Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / The amount of precipitations for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.




Figure Nr.19. – Situata e reshjeve mbi dhe nën normë për pjesë të ndryshme të vendit tonë, sipas një vlerësimi në shkallë më të gjërë rajonale për periudhën 1 prill deri 12 shtator 2022.
The rainfall situation above and under the norm for different zones of our country according to an evaluation for a large regional area for the period April 1 until September 12, 2022.

Duhet thënë se hapësira e vendit tonë prej më shumë se 5 muajsh karakterizohet me një situatë deficietare sa i takon reshjeve, pamvarësisht nga ndryshimet e vogla midis zonave të ndryshme të vendit. Kjo situatë paraqitet dhe në grafikët e dhënë në figurën Nr.19.

Ndërkohë në një analizë më të detajuar për lartësinë e reshjeve në hapësirën e Ballkanit në figurën Nr.20 paraqiten të dhënat e këtij elementi meteorologjik për muajin shtator 2022 si dhe vlerat e percentileve në hartën e dhënë në figurën Nr.21.

Situata me shpërndarjen e reshjeve për muajin shtator 2022 për Shqipërinë është dhënë në hartën e paraqitur në figurën Nr.23, ndërsa grafiku i dhënë në figurën Nr.22 paraqet të dhënat e treguesit të numrit të ditëve me reshje gjatë këtij muaji.

Muaji shënoi vlera më të larta se norma për sa i takon reshjeve ashtu dhe numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm.

It must be said that the space of our country for more than 5 months was characterized by a deficit situation regarding rainfall, regardless of the small differences between different areas of the country. This situation is also presented in the graphs given in figure No.19.

Meanwhile, in a more detailed analysis of the height of the rainfall in the Balkans in figure No.20, the data of this meteorological element for the month of September 2022 are presented, as well as the percentile values in the map given in figure No.21.

The situation with the distribution of rainfall for the month of September 2022 for Albania is given in the map presented in figure No.23, while the graph given in figure No.22 presents the data of the indicator of the number of rainy days during this month. The month had values higher than the norm were recorded both in terms of precipitation and the number of days with precipitation above the 1.0 mm threshold.




Figure Nr.20 – Vlerat e reshjeve të muajit Shtator 2022 në territorin e Ballkanit.
The values of precipitation in the Balkan area for the September month 2022.




Figure Nr.21 – Vlerat e percentileve për reshjet e muajit Shtator 2022 në territorin e Ballkanit.
The values of percentiles in the Balkan area for the September month 2022.





Figure Nr.22. – Numri i ditëve me reshje për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / The rainy days for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.

Në hartën e dhënë në figurën Nr.24 ku paraqitet treguesi i numrit të ditëve me reshje rezulton dukshëm që pjesa veriore e vendit gjatë muajit shtator 2022 ka shënuar një numër më të lartë të ditëve me reshje, ndërkohë që pjesa JL shënon vlerat më të ulta.

Në analizën e reshjeve një rëndësi të veçantë ka dhe vlerësimi i reshjeve dhe ditëve me reshje mbi pragje të ndryshme. Në vijim në grafikun e dhënë në figurën Nr.25 paraqiten të

In the map given in figure No.24, where the indicator of the number of rainy days is presented, it is evident that the northern part of the country during the month of September 2022 has recorded a higher number of rainy days, while the southern part shows the lowest values.

In the analysis of precipitation, the assessment of precipitation and days with precipitation above different thresholds is of



dhënat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm.

Ajo që vlen të theksohet në këtë analizë të reshjeve të vrojtura gjatë muajit shtator 2022 është fakti se ndonëse në totalin e tyre reshjet e vrojtura shënojnë vlera mbi normë, shpërndarja e tyre në territor dhe anomalitë ndryshojnë sipas zonave.

particular importance. Next, in the graph given in figure No.25, they are presented the

data of the index of the number of days with precipitation above the range of 10.0 mm.

What is worth emphasizing in this analysis of the rainfall observed during the month of September 2022 is the fact that although in total the observed rainfall has values above the norm, their distribution in the territory and anomalies vary according to areas.




Figure Nr.24. – Numri i ditëve me reshje >1.0 mm për muajin Shtator 2022 për Shqipërinë.

The number of rainy days >1.0 mm for September 2022 for Albania.





Figure Nr.25. – Numri i ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / The rainy days above the threshold 10.0 mm for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.




*Figure Nr.26 – Vlerat e reshjeve përgjatë dy periudhave më intensive të tyre në kontinentin Europian gjatë muajit Shtator 2022.
The values of precipitation in European continent during two periods with highly intensive precipitation during September 2022.*

Në shkallë kontinenti për situatën e veçantë të periudhës 6-12 shtator 2022, me reshje më të shumta si dhe ato që u vrojtuan në fund muaji nga data 25 shtator deri më 1 tetor 2022 në figurën Nr.26 paraqiten hartat përkatëse; ku dukshëm për këtë të fundit evidentohen dy vatra me nivel të lartë të reshjeve, njëra prej të cilave i takon pjesës VP të Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Një pamje ilustruese e kësaj situatë me paqëndrueshmëri atmosferike jepet në figurën Nr.27 për Tiranën më datë 28.09.2022, e cila u shoqërua me vranësira në mbarë vendin.

Pikërisht gjatë kësaj periudhe u vrojtuan dhe reshjet më intensive, të cilat preken pothuajse gjithë vendin. Në figurën Nr.28 paraqitet grafiku me reshjet maksimale 24 orëshe që u vrojtuan në territorin e Shqipërisë gjatë muajit shtator 2022.

Ndërkohë në figurën Nr.29 dhe Nr.30 paraqiten respektivisht hartat me anomalitë e reshjeve të muajit shtator (në %) si dhe vlerat maksimale 24 orëshe (në mm) të vrojtuar gjatë këtij muaji në vendin tonë.



At the continental level, for the particular situation of the period September 6-12, 2022, with the most rainfall, as well as the one observed at the end of the month from September 25 to October 1, 2022, the relevant maps are presented in figure No.26; where apparently for the latter two foci with a high level of precipitation are evident, one of which belongs to the NW part of Albania and Montenegro.

An illustrative picture of this situation of atmospheric instability is given in the figure Nr.27 for Tirana on 28.09.2022, which was accompanied by clouds throughout the country.

Precisely during this period, the most intense rains were observed, which affected almost the entire country. Figure No.28 shows the graph with the maximum 24-hour rainfall that was observed in the territory of Albania during the month of September 2022.

Meanwhile, in figure No.29 and No.30, respectively, the maps with rainfall anomalies (in %) for the month of September, as well as the maximum 24-hour values (in mm) observed during this month in our country, are presented.




Figure Nr.28. – Reshjet maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të muajit Shtator 2022 për Shqipërinë. / The 24 hour maximal precipitation for some meteorological stations of September month 2022 for Albania.

Të dhënat mbi reshjet e parashikuara 24 orëshe janë një informacion i rëndësishëm për të ri-analizuar situatën mbizotëruese me reshje për muajin Shtator 2022, të cilat sipas produkteve të platformës SEEFFG, janë paraqitur në figurën Nr.31.

The forecast data on 24-hour precipitation is an important information to re-analyze the prevailing precipitation situation for September 2022, which according to the products of the SEEFFG platform, are presented in Figure No.31.




Figure Nr.29. – Anomalitë e reshjeve në % kundrejt vlerave të normës 1991-2020 për muajin Shtator 2022 për Europën. The precipitations anomalies in % for September month 2022 compare to norm values 1991-2020 for Europe.





Figure Nr.30. – Lartësia maksimale 24 orëshe e reshjeve për muajin Shtator 2022 për Shqipërinë.

The 24 hour maximal precipitation values of September month 2022 for Albania.




*Figure Nr.31. Vlerësimi i reshjeve të pritshme çdo ditë, për 24 orët në vijim sipas platformës “SEFFG” për muajin Shtator 2022.
The estimation for the expected precipitation on the next 24 hours according to the platform “SEFFG” for September month 2022.*

Agrometeorologji

Muaji shtator – vjeshtë e parë, përgjithësisht në territorin e Shqipërisë shënon fillimin e fundit të periudhës së vegetacionit në zonën e lartë. Gjithësesi në vitet e fundit është shënuar një zgjatje e kësaj periudhe dhe një mbarim më i vonë. E njëjta situatë duket se nuk mungoi dhe këtë vit. Në vijim në figurën Nr.32 paraqiten hartat me treguesit e vegetacionit NDVI për 5 javët e muajit shtator 2022 për Shqipërinë, ku evidentohet një vegetacion i gjallë ende i pranishëm edhe në javën e fundit në mbarë territorin. Për këtë situatë ndikuan pozitivisht dhe reshjet e vrotuara në mbarë territorin ashtu si dhe vlerat relativisht të larta të temperaturave.

Agrometeorology

